



Br. X/597 Data 26.08.2022  
Datimi



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**



Bazuar në nenet 67 dhe 68 të Ligjit të Zyrtarët Publik nr.06/L-114, neni 5 paragrafi c, Ligjiti Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, neni 35 të Ligjiti nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhezimin Administrativ: Nr.08/2021 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhezimit Administrativ Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshëm dhe në kërkesën me nr.X-590 datë 22.08.2022, Komuna e Obilic rishpall:

**KONKURS**

(Për plotësimin e vendeve të punës)

**SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” - Obilic**

**Titulli i vendit të punës: Asistent për fëmijet, nxënësit me nevoja të veçanta.**

Institucioni: Komuna e Obilic

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Lloji i pozitës: Nëpunës i shërbimit publik

Numri i pozitës: 2 (njëri prej tyre lëvizës edhe në IA tjera të komunës)

Titulli i mbikëqyrës: Drejtori i shkollës

Paga Bazë: 397.01 euro

Orët e punës në javë: 20 orë

Orë e mësimin në javë: 20 orë

Periudha e kontratës: Në kohë të pacaktuar.

**SHFMU “Hasan Prishtina” - Milloshevë**

**Titulli i vendit të punës: Asistent për fëmijet, nxënësit me nevoja të veçanta.**

Institucioni: Komuna e Obilic

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Lloji i pozitës: Nëpunës i shërbimit publik

Numri i pozitës: 1

Titulli i mbikëqyrës: Drejtori i shkollës

Paga Bazë: 397.01 euro

Orët e punës në javë: 20 orë

Orë e mësimin në javë: 20 orë

Periudha e kontratës: Në kohë të pacaktuar.

**Kualifikimi për asistentë për fëmijët, nxënësit me nevoja të veçanta:**

- Shkolla e Mesme dhe Niveli 5-të (Postsekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë, nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- Përgatitja adekuate profesionale sipas Udhezimit Administrativ Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

**Detyrat për asistent të fëmijëve, nxënësve me nevoja të veçanta arsimore:**

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë.
- Punon me mësmdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndët të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve.
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës.
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/ personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim.
- Promovon bashkëpunimin shkollë – shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin.
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve.
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajtojnë si plotësisht konfidenciale.

**Dokumnetet e nevojshme:**

- Formulari i konkurrimit të jetë i plotësuar;
- Biografia (CV);
- Dokumeti personal (letërnjoftimi kopje);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata e shtetësisë;
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Certifikata e diplomimit e noterizuar (të mos jetë më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit);

- Certifikata që nuk është nënhetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim nëse ka.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen, ndërsa origjinalet kërkohen me rastin e intervistës.

Afati dhe mënyra e konkurrimit: 30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë.

Aplikacionet dorëzohen prej 26.09.2022 deri më 10.10.2022, ora 15:30 në zyrën pritëse të komunës.

Aplikacionet merren në zyrën pritëse në Komunën e Obiliqit dhe mund të shkarkohet edhe në faqen zyrtare të saj.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net>

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe ato të pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë do të ftohen përmes postës elektronike apo telefonit.

**Drejtori i Arsimit**

Sahit Zeqiri

